



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 05.11.2019

RAPORT

**“MBI VLERËSIMIN E KANDIDATURAVE PËR ANËTARË TË GJYKATËS
KUSHTETUESE, VAKANCA E PLOTË E SHPALLUR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË
NË DATË 4.03.2019”**

- Hyrje

Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 4.03.2019, në cilësinë e organit të emërtesës, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Bashkim Dedja.

Pas përfundimit të afatit të aplikimit, në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, është publikuar lista me emrat e 9 kandidatëve që kishin shprehur interesin për të konkurruar për plotësimin e kësaj vakance.

Njëkohësisht Kuvendi i Shqipërisë, i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i zgjedhur me shortin e hedhur në datë 7 dhjetor 2018, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

Në përfundim të procedurave të verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit **për 3 kandidatë**, nga 9 kandidatë që kishin paraqitur interesin për të aplikuar për këtë vakancë.

Në përfundim të procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve të kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në mbledhjen e datës 21.09.2019, miratoi Raportin e arsyetuar dhe Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 4.03.2019 si më poshtë:

1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë

2) Fiona Papajorgji 88.785 Pikë

3) Elsa Toska 85.428 Pikë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. 654 prot., datë 14.10.2019, (protokolluar me shkresën nr. 3630, datë 14.10.2019) ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë, “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe Raportin e Arsyetuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 4.03.2019.

Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se:

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me Vendimin nr.134, datë 21.09.2019, ka miratuar “Listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 4.03.2019”;
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me Vendimin nr. 135, datë 21.09.2019, ka miratuar “Raportin për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 4.03.2019”.

Bashkëlidhur praktikës së dërguar KED ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë të gjitha vendimet e tjera të marra nga ky organ për lejimin e kandidimit, vlerësimin dhe pikëzimin e tre kandidatëve. Gjithashtu, KED ka paraqitur edhe vendimet për ndalimin e kandidimit të 4 (katër) aplikantëve që nuk përmbushën kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit, si dhe vendimet për përfundimin e procedurës së verifikimit të 2 (dy) kandidatëve të tërhequr nga kandidimi.

- *Vlerësimi i kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

Neni 125 i Kushtetutës, parashikon se:

“...4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

Bazuar në Vendimet nr.56, nr.62, nr.105, nr.122, nr.124 dhe nr.125 si dhe Raporti për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar, të miratuar nga KED, për kandidaturat e listës së mësipërme Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut konstatoi sa më poshtë:

Kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, znj. Arta Vorpsi:

*I. Në drejtim të përmbushjes së **kritereve dhe kushteve ligjore** rezulton se kandidatja Arta Vorpsi:*

▪ Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga vendimi nr. 56/2019 i KED rezulton se kandidatja Arta Vorpsi ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1996 si juriste, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

▪ Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar nga KED referuar vendimit nr. 57/2019 përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj, rezulton se kandidatja Arta Vorpsi ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Asistent avokat, për periudhën 1996-1997;
- b) Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë për periudhën 1997-1998 pranë Gjykatë Kushtetuese;
- c) Nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, Drejtore e Drejtorisë së Studimeve dhe Botimeve pranë Gjykatës Kushtetuese, për periudhën 2001-2005;
- ç) Këshilltare ligjore pranë Gjykatë Kushtetuese, për periudhën 2005 dhe aktualisht,
- d) Gjyqtare *ad hoc*, për periudhën 2015 e në vijim, pranë gjykatës Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ;
- dh) Pedagoge e jashtme e së drejtës kushtetuese, e së drejtës kushtetuese të krahasuar, si dhe e të drejtave të njeriut (e angazhuar me kohë të pjesshme), pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Shkollës së Magjistraturës dhe në Shkollat e Larta Jopublike “Luarasi” dhe “Universiteti European i Tiranës”.

▪ Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidates, Këshilli ka konstatuar se kandidatja Arta Vorpsi nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike;

▪ Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ***mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit***, pas shqyrtimit të jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e

kandidates për veprimtaritë e ushtruara prej saj, si edhe shkresat me përgjigje të dërguara sipas kërkesës së Këshillit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga parti politike, KED ka konstatuar se kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton që të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike;

- Lidhur me kushtin që kandidatja të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019, që janë të administruara në dosjen e kandidates në KED, referuar vendimit të Këshillit rezulton se, gjatë marrëdhënies së punës me Gjykatën Kushtetuese, kandidatja Arta Vorpsi nuk ka marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore apo administrative të regjistruar, që nga fillimi i marrëdhënieve të punës;

II. Në drejtim të **kontrollit të pasurisë, të integritetit dhe kushteve të tjera ligjore**, nga procesi i verifikimit të kryer nga KED rezulton se kandidatja Arta Vorpsi:

- ka “kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë personale dhe të familjarëve të saj”;
- nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kandidati “ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”;
- nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të saj, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- nuk ndodhet në kushtet e ndalimit përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë.

III. Në drejtim të renditjes së kandidates **në bazë të meritave profesionale dhe morale**:

Meritat profesionale:

- *Vjetërsia në profesion:* Në momentin e vlerësimit nga KED, kandidatja ka gjithsej rreth 18 vjet dhe 8 muaj vjetërsi në punë;
- *Historiku arsimor:* rezulton se kandidatja ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 9.2;

- *Kualifikime pasuniversitare:* Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi ka ndjekur studimet pasuniversitare për Master të Nivelit të Dytë, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri, në periudhën 1998-1999 dhe me vlerësimin Pozitivisht (nuk aplikohet vlerësimi me notë), duke marrë titullin “Magister/Master i shkencave juridike”. Në vijim, ka ndjekur studimet pasuniversitare po në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri, në periudhën 1999-2001 dhe me vlerësimin “Pozitivisht” (nuk aplikohet vlerësimi me notë), duke marrë titullin “Doktor i Shkencave juridike (Doctor iuris)”. Sipas shkresës nr. 2110 prot./datë 06.04.2009 Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës konfirmohet se me vendimin nr. 160 datë 20.03.2009 grada shkencore e sipërcituar “është e barasvlefshme me gradën “doktor” në Republikën Shqipërisë”.

Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi ka ndjekur 13 veprimtari trajnimi afatshkurtra dhe disa për një periudhë mbi dy javore, në pjesën më të madhe të tyre në Gjermani, Holandë, Itali dhe pranë GJEDNJ. Tematika e një pjesë të këtyre veprimtarive lidhet me të drejtat e njeriut, procesin e rregullt ligjor, të drejtën kushtetuese evropiane, impaktin dhe efektet e vendimeve të gjykatës kushtetuese etj.

- *Njohja e gjuhëve të huaja:* Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi zotëron dy gjuhë të huaja, Anglisht dhe Gjermanisht.
- *Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional:* Në cilësinë e autores apo bashkëautore, kandidatja ka përgatitur 12 publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si edhe 25 artikuj të tjerë profesionalë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara kryesisht në fushën e drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Sipas të dhënave zyrtare të përcjella nga Gjykata Kushtetuese pranë KED, për periudhën pesëvjeçare 08.10.2013 deri në 31.07.2018, rezulton se kandidatja Arta Vorpsi është ngarkuar që të përgatisë dhe ka relatuar gjithsej 197 çështje, për të cilat janë dhënë 43 vendime përfundimtare dhe 154 vendime moskalimi. Ndërkohë, kandidatja ka përgatitur relacion, opinion ligjor apo projektvendim edhe për 12 çështje të tjera, përfundimi i të cilave lidhet me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

KED pas shqyrtimit dhe analizës së pesë indikatorëve që përbëjnë vlerësimin cilësor të dokumentacionit profesional të paraqitur nga kandidatja, si dhe numrin e publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë, vlerëson se kandidatja paraqet qasje profesionale origjinale dhe të thelluar të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit por edhe aktualisht ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e

tyre, vërehet edhe dobishmëria dhe impakti pozitiv i këtyre punimeve në praktikën gjyqësore, në zhvillimin e debatit profesional e doktrinar, si edhe njohjen e të drejtave nga publiku më i gjerë.

▪ *Kualifikimi Shtesë Profesional*

Sipas vlerësimit të KED, angazhimet shtesë profesionale të kandidatës janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave ligjore dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, të drejtat e fëmijëve, antidiskriminimi, barazia gjinore, aksesit në drejtësi, mirëfunksionimi i sistemit të drejtësisë, etj. Njëkohësisht kandidatja është angazhuar në përgatitjen e projekteve mbi dispozitat e reja kushtetuese mbi sistemin e drejtësisë dhe legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi.

Këshilli argumenton se formimi profesional, i kandidatës e ndërthurur me angazhimin e saj si lektore e jashtme e së drejtës kushtetuese, së drejtës kushtetuese të krahasuar, si edhe e të drejtave të njeriut së bashku me hartimin e një sërë punimeve shkencore dhe artikujsh profesionale, dëshmon për formimin juridiko-profesional, jo vetëm në aspektin teorik por edhe të zbatimit e të ndikimit efektiv në praktikë, të specializimit dhe ekspertizës ligjore, veçanërisht në fushën e të drejtës kushtetuese, të lirive themelore e të drejtave të njeriut, si edhe të aspekteve të ndryshme të juridiksionit kushtetues.

Meritat Morale

- *Integriteti Etik dhe moral:* Sipas vlerësimit të KED, kandidatja ka respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj.
- *Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve:* Bazuar në vlerësimin e Këshillit kandidatja ka ushtruar me seriozitet, maturi dhe besnikëri detyrimet profesionale në ushtrimin e funksioneve pranë Gjykatës Kushtetuese dhe reflekton angazhim të spikatur dhe përgjegjshmëri në veprimtarinë e saj profesionale jashtë ushtrimit të këtij funksioni.
- *Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile:* Kandidatja sipas vlerësimit të Këshillit nuk rezulton e angazhuar në veprimtari të tjera të jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

- *Cilësia e platformës dhe të vizionit:* Në gjykimin e Këshillit, kandidatja Arta Vorpsi paraqiti një nivel shumë të lartë dhe të dallueshëm të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar në mënyrë profesionale, shumëplanëshe e të hollësishme çështje dhe

problematika aktuale dhe të së ardhmes me të cilat duhet të përballët Gjykata Kushtetuese.

- *Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore:* KED argumenton se ushtrimi i detyrës së menaxhimit të një drejtorie, dhe veprimtaria profesionale si këshilltare ligjore e Gjykatës Kushtetuese dhe në veçanti, mendimet dhe zgjidhjet e sugjeruara për tematika të rëndësishme të fushës ligjore në punimet shkencore dhe artikujt e publikuar nga kjo kandidatë tregojnë të dhëna premtuese edhe për marrjen e përgjegjësisë dhe nismës për vendimmarrje.
- *Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik:* Në gjykimin e KED kandidatja zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për tu përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen.
- *Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore:* KED çmon kandidatja Arta Vorpsi është përfshirë vijimësisht në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e publikimeve të shumta shkencore dhe artikujve profesionalë dhe zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup.

Në përfundim të vlerësimit Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 4.03.2019, duke e renditur të parën në listën përfundimtare të renditjes së gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim, me **89.642 pikë**.

Kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, Znj. Fiona Papajorgji:

*I. Në drejtim të përmbushjes së **kritereve dhe kushteve ligjore** rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji:*

- Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati **të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë**, nga vendimi nr. 62/2019 të KED rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2000 në shkenca juridike , në “Universiteta degli Studi Aldo Moro” në Bari, Itali (Diploma e konvertuar nga Ministria e Arsimit në Shqipëri). Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

- Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe

shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë **të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike**, nga dokumentacioni i shqyrtuar nga KED referuar vendimit nr. 62/2019, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidates nga KED, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Avokate pranë Dhomës së Avokatisë në Bari, Itali, për periudhën Janar 2004 - Dhjetor 2008;
- b) Pedagoge efektive pranë Departamentit të Shkencave Juridike në *Albanian University*. Lënda Regjimi juridik i tokës; si dhe Grupet jofitimprurës të interesit. Bachelor, për periudhën Nëntor 2007- Mars 2009;
- c) Specialiste e nivelit të lartë pranë Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese, për periudhën Mars 2009- Maj 2011;
- ç) Këshilltare ligjore pranë Gjykatë Kushtetuese, për periudhën 18 Maj 2011 dhe aktualisht;
- d) Lektore e së drejtës publike pranë Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë (Nëntor 2007- aktualisht), lektore për regjimin juridik të tokës, si edhe për grupet jofitimprurës të interesit pranë *Albanian University* (Mars 2009 – Dhjetor 2010), lektore për teknikën legislative pranë Universitetit Europian të Tiranës (Mars 2018-Qershor 2018).

▪ Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që **kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit**, sikurse parashtrohet në pikën 58 më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidates nga KED për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli ka konstatuar se kandidatja nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike;

▪ Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati **të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit**, pas shqyrtimit i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidates për veprimtaritë e ushtruara prej saj, si edhe shkresat me përgjigje të dërguara sipas kërkesës së Këshillit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga parti politike, Këshilli ka konstatuar se kandidatja Fiona Papajorgji nuk rezulton që të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike;

▪ Lidhur me kushtin që kandidatja **të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi**, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019, që janë të administruara në dosjen e kandidates në KED, referuar vendimit të Këshillit rezulton se, gjatë marrëdhënies së punës me Gjykatën Kushtetuese,

kandidatja Fiona Papajorgji nuk ka marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore apo administrative të regjistruar, që nga fillimi i marrëdhënieve të punës.

I. Në drejtim **të kontrollit të pasurisë, të integritetit dhe kushteve të tjera ligjore**, kandidatja Fiona Papajorgji, nga procesi i verifikimit të kryer nga KED rezulton se kandidatja:

- ka “kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë personale dhe të familjarëve të saj” dhe për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.
- nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kandidati “ç) *të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*”;
- nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të saj, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- nuk ndodhet në kushtet e ndalimit përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë.

II. Në drejtim të renditjes së kandidates **në bazë të meritave profesionale dhe morale**:

Meritat profesionale:

- Vjetërsia në profesion: Në momentin e vlerësimit, kjo kandidate ka gjithsej rreth **15 vjet e 9 muaj** vjetërsi në punë;
- Historiku arsimor: Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga “Università degli Studi Aldo Moro” Bari, Itali dhe vetëdeklarimi i bërë nga kandidatja Fiona Papajorgji, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me rezultatin **29.6/30** e konvertuar me notë mesatare **mbi 9**;
- Kualifikime pasuniversitare: Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Fiona Papajorgji në periudhën 2004-2008 ka përfutur titullin Avokat, të lëshuar nga *Ordine degli Avvocati di Bari* (Dhoma e Avokatisë Bari). Gjithashtu, në vitin 2008 ka marrë titullin Avokat edhe në Shqipëri. Në vijim, ka ndjekur studimet pasuniversitare po në “Università degli Studi ‘Aldo Moro’”,

Bari, Itali, (Shkenca Juridike) në periudhën 2009 – 2012, duke marrë titullin “*Doktor i Shkencave Juridike*”. Kjo diplomë është njohur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës së Republikës së Shqipërisë me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademik me nr. Rendor 123, datë 10.09.2012, konfirmuar me vërtetimin nr.5090/5 prot., datë 12.09.2012 të Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademik.

Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës nga KED dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Fiona Papajorgji ka ndjekur 16 veprimtari trajnimi afatshkurtra dhe disa për një periudhë mbi dy javore, në pjesën më të madhe të tyre në Greqi, Kroaci, Spanjë, Turqi, Itali dhe pranë Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, Strasburg. Tematika e një pjesë të këtyre veprimtarive lidhet me të drejtat e njeriut, procesin e rregullt ligjor, të drejtën kushtetuese europiane, të drejtën administrative europiane etj.

- Njohja e gjuhëve të huaja: Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Fiona Papajorgji zotëron dy gjuhë të huaja Italisht dhe Anglisht. Kandidatja ka ndjekur me kohë të plotë në gjuhën italiane studimet e plota universitare dhe ato pasuniversitare duke fituar edhe gradën shkencore “Doktor i shkencave juridike” në “Università degli Studi ‘Aldo Moro’” në Bari, Itali, si edhe ka ushtruar profesionin e avokatit në Itali për një periudhë pesë vjeçare.
- Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional:

Kandidatja Fiona Papajorgji, në cilësinë e bashkëautore ka përgatitur 1 publikim shkencor, botuar në vitin 2008, titulluar “Grupet jofitimprurëse të interesit, cikël leksionesh” dhe është autore e disa punime të tjera referuar në aktivitete shkencore, sikurse tregohen më poshtë;

Sipas të dhënave zyrtare të përcjella nga Gjykata Kushtetuese pranë KED, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese dhe të detyrës që ka ushtruar, për periudhën pesëvjeçare 08.10.2013 deri në 31.07.2018, rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji është ngarkuar që të përgatisë dhe ka relatuar gjithsej 159 çështje, për të cilat janë dhënë 39 vendime përfundimtare dhe 120 vendime moskalimi. Ndërkohë, kandidatja ka përgatitur relacion, opinion ligjor apo projektvendim edhe për 18 çështje të tjera, përfundimi i të cilave lidhet me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

KED duke marrë në konsideratë dokumentet profesionale të shqyrtuara, numrin e publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë, konstaton se këto dokumente dëshmojnë qasje profesionale origjinale dhe të thelluara të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit por edhe aktualisht ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e tyre duke sjellë argumente dhe përfundime me interes, vërehet edhe dobishmëria dhe impakti pozitiv i këtyre punimeve në praktikën

gjyqësore, në zhvillimin e debatit profesional e doktrinal, si edhe njohjen e të drejtave nga publiku më i gjerë, përfshirë edhe për qëllimet praktike të përdorimit të ligjit në rastet kur mund të pretendojnë njohjen apo kërkojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

▪ *Kualifikimi Shtesë Profesional*

Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Fiona Papajorgji, rezulton se historiku dhe karriera profesionale e kësaj kandidateje është i fokusuar në pjesën më të konsiderueshme të kohëzgjatjes dhe shtrirjes së saj në fushën e drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Ndërkohë, konstatohet që kandidatja të ketë gjithashtu edhe një përvojë të gjerë profesionale, si avokate dhe përvoja akademike në fusha të tjera të së drejtës. KED ka arritur në këtë përfundim nga fakti që veprimtaria profesionale e kandidates është e lidhur për më shumë se 10 vjet me ushtrimin e detyrave profesionale pranë Gjykatës Kushtetuese përvojë e cila, e lidhur edhe me interesin e dëshmuar vetjak profesional, ka ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e kësaj kandidateje në fushat e së drejtë kushtetuese dhe të drejtave të njeriut.

Meritat Morale

- Integriteti Etik dhe moral: Sipas vlerësimit të KED nuk rezultojnë të dhëna që kandidatja të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune.
- Për sa i përket kriterit vlerësues “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Fiona Papajorgji në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të saj për zbatimin e drejtë të ligjit sipas kompetencave dhe përgjegjësi që i ngarkon ligji.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

- Cilësia e platformës dhe të vizionit: Këshilli ka vlerësuar se kandidatja Fiona Papajorgji paraqiti një nivel të thelluar dhe të dallueshëm njohjeje të rolit dhe pritshmërive për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, njohje të thellë të praktikave të mira të krijuara nga kjo Gjykatë, por edhe të vështirësive që kjo Gjykatë ka hasur gjatë funksionimit të saj. Ajo është e vetëdijshme për rëndësinë e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe rolin themelor të kësaj gjykate në mirëfunksionimin e sistemit demokratik, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetit ligjor, respektimit të lirive

themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi për zhvillimin ekonomik e social të vendit.

- Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore: Këshilli vlerëson se eksperiencat si avokate e ka vënë kandidaten përballë nevojave dhe eksperiencave vendimmarrëse mbi mbrojtjen më të mirë të interesave të klientëve të saj. Nga ana tjetër, veprimtaria profesionale si këshilltare ligjore e Gjykatës Kushtetuese dhe në veçanti, nisma dhe kurajo profesionale e përzgjedhjes së çështjeve të trajtuara, mendimet dhe zgjidhjet e sugjeruara për tematika të rëndësishme të fushës ligjore në punimet shkencore të përgatitura nga kjo kandidatë tregojnë të dhëna premtuese edhe për marrjen e përgjegjësi dhe nismës për vendimmarrje, të cilat, së bashku me profesionalizimin kanë rëndësi thelbësore për ushtrimin e suksesshëm të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese
- Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik: Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se kandidatja Fiona Papajorgji zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për tu përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

Në përfundim të vlerësimit Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Fiona Papajorgji, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019, duke e renditur të dytën në listën përfundimtare të renditjes së gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim me **88.785** pikë.

Kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, Znj. Elsa Toska:

*I. Në drejtim të përmbushjes së **kritereve dhe kushteve ligjore** rezulton se kandidatja Elsa Toska:*

- Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati **të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë**, nga vendimi nr. 105/2019 të KED rezulton se kandidatja Elsa Toska ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1996- 2000 si “Juriste”, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Juridik. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për

Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

▪ Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati **të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike**, nga dokumentacioni i shqyrtuar nga KED, referuar vendimit nr. 105/2019, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidates nga KED, rezulton se kandidatja Elsa Toska ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Ndhmës\Komisionere pranë Avokatit të Popullit, për periudhën Shtator 2000 - Shkurt 2006;
- b) Avokate, për periudhën Korrik 2006 - Mars 2007, pranë “Boga & Associates & KPMG”;
- c) Këshilltare Ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, për periudhën Prill 2007- Aktualisht.
- ç) Lektore dhe eksperte në Shkollën e Magjistraturës, Shkollën e Administratës Publike, Shkollën e Avokatisë, Fakultetet e Drejtësisë, Ekonomik dhe atij të Shkencave Sociale në universitet publike, Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar të Tiranës, Universitetin Polis, Universitetin Justicia, Universitetin Ilyria dhe Universitetin Luarasi.

▪ Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që **kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit**, nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidates, Këshilli ka konstatuar se kandidatja Elsa Toska nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike;

▪ Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati **të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit**, pas shqyrtimit të jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidates për veprimtaritë e ushtruara prej saj, si edhe shkresat me përgjigje të dërguara sipas kërkesës së Këshillit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga parti politike, Këshilli ka konstatuar se kandidatja Elsa Toska nuk rezulton që të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike;

▪ Lidhur me kushtin që kandidatja **të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi**, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën

nr.144/1 prot, datë 23.04.2019, që janë të administruara në dosjen e kandidates në KED, referuar vendimit të Këshillit rezulton se, gjatë marrëdhënies së punës me Gjykatën Kushtetuese, kandidatja Elsa Toska nuk ka marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore apo administrative të regjistruar, që nga fillimi i marrëdhënieve të punës.

II. Në drejtim të kontrollit të pasurisë, të integritetit dhe kushteve të tjera ligjore, nga procesi i verifikimit të kryer nga KED rezulton se kandidatja Elsa Toska:

- ka “kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë personale dhe të familjarëve të saj” dhe për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.
- nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kandidati “ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”;
- nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të saj, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- nuk ndodhet në kushtet e ndalimit përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë.

III. Në drejtim të renditjes së kandidates në bazë të meritave profesionale dhe morale:

Meritat profesionale:

- *Vjetërsia në profesion:* Në momentin e vlerësimit nga KED, kjo kandidate ka gjithsej rreth 18 vjet 6 muaj vjetërsi në punë;
- *Historiku arsimor:* rezulton se kandidatja ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 9.9;
- *Kualifikime pasuniversitare:* Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Elsa Toska ka ndjekur studimet pasuniversitare për Master të Nivelit të Dytë, në Universitetin e Tiranës, në periudhën 2003 – 2005, duke marrë titullin “*Master në Studime Europiane*”. Në vijim, ka ndjekur studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në periudhën 2010-2012, duke marrë titullin “*Doktore Shkencash*”.

Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës nga KED dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Elsa Toska ka ndjekur 10 veprimtari trajnimi afatshkurtra dhe disa për një periudhë mbi dy javore, në pjesën më të madhe të tyre në Shqipëri, Francë, Holandë, Suedi dhe pranë GJEDNJ-së. Tematika e një pjese të këtyre veprimtarive lidhet me të drejtat e njeriut, procesin e rregullt ligjor, të drejtën kushtetuese europiane, shtetin e së drejtës etj.

- *Njohja e gjuhëve të huaja:* Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës nga KED dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Elsa Toska zotëron një gjuhë të huaj, Anglisht. Për njohjen e gjuhëve të huaja është paraqitur edhe dokumenti i lëshuar për zotërimin e tyre, çertifikatë “IELTS AKADEMIK”, nga British Council, Albania.

- *Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional:*

Kandidatja Elsa Toska, në cilësinë e autores apo bashkëautores, ka përgatitur 13 publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si edhe 25 artikuj të tjerë profesional, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara kryesisht në fushën e drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

Sipas të dhënave zyrtare të përcjella nga Gjykata Kushtetuese pranë KED, për periudhën pesëvjeçare 08.10.2013 deri në 31.07.2018, rezulton se kandidatja Elsa Toska është ngarkuar që të përgatisë dhe ka relatuar gjithsej 43 çështje, për të cilat janë dhënë 17 vendime përfundimtare dhe 26 vendime moskalimi. Ndërkohë, kandidatja ka përgatitur relacion, opinion ligjor apo projektvendim edhe për 20 çështje të tjera, përfundimi i të cilave lidhet me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

KED duke marrë në konsideratë dokumentet profesionale të shqyrtuara, numrin e publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë, konstaton se këto dokumente dëshmojnë qasje profesionale origjinale dhe të thelluara të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit por edhe aktualisht ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e tyre duke sjellë argumente dhe përfundime me interes, vërehet edhe dobishmëria dhe impakti pozitiv i këtyre punimeve në praktikën gjyqësore, në zhvillimin e debatit profesional e doktrinal, si edhe njohjen e të drejtave nga publiku më i gjerë, përfshirë edhe për qëllimet praktike të përdorimit të ligjit në rastet kur mund të pretendojnë njohjen apo kërkojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

- *Kualifikimi Shtesë Profesional*

Kandidatja Elsa Toska ka punuar për 14 vite si lektore/pedagoge e jashtme e lëndëve të së drejtës administrative në disa universitete publike dhe jopublike. Njëkohësisht kandidatja ka qenë pjesë e tre grupeve të punës gjatë reformës në drejtësi, me kompetenca analizuese dhe draftuese ligjore lidhur me amendimet kushtetuese,

ndryshimet në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe projektligjin për Presidentin e Republikës.

Këshillit ka vlerësuar se kandidatja Elsa Toska dëshmon formimin e saj të plotë juridiko-profesional, si edhe arritjen e një niveli të spikatur dhe të dallueshëm, jo vetëm teorik por edhe të zbatimit e të ndikimit efektiv në praktikë, të specializimit dhe ekspertizës ligjore të thelluar në fushën e të drejtës kushtetuese, dhe të lirive themelore e të drejtave të njeriut.

Meritat Morale

- *Integriteti Etik dhe moral:* Sipas vlerësimit të KED nuk rezultojnë të dhëna që kandidatja të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune.
- *Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve:* Bazuar në vlerësimin e Këshillit rezulton se kandidatja Elsa Toska ka ushtruar me seriozitet, maturi dhe besnikëri detyrimet profesionale në ushtrimin e funksioneve pranë Gjykatës Kushtetuese dhe reflekton angazhim e përgjegjshmëri shumë të mirë edhe në veprimtari të saj profesionale jashtë ushtrimit të këtij funksioni.
- *Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile:* sipas vlerësimit të Këshillit rezulton se kandidatja Elsa Toska nuk ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

- *Cilësia e platformës dhe të vizionit:* Këshilli ka vlerësuar se kandidatja Elsa Toska paraqiti një nivel të plotë dhe të gjerë të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, si edhe të kësaj Gjykate.
- *Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore:* KED argumenton se veprimtaria profesionale e kandidates si këshilltare ligjore e Gjykatës Kushtetuese natyra e çështjeve të trajtuara, por dhe mendimet dhe zgjidhjet e sugjeruara për tematika të rëndësishme të fushës ligjore në punimet shkencore dhe artikujt e publikuar nga kjo kandidate tregojnë të dhëna premtuese edhe për marrjen e përgjegjësi dhe nismës për vendimmarrje.
- *Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik:* Në gjykimin e KED kandidatja Elsa Toska zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik, pra për të përfaqësuar atë që mendon se është e përbashkët me të tjerë në lidhje me një çështje apo kauzë të caktuar.

- *Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore:* KED çmon se prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se kandidatja Elsa Toska zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

Në përfundim të vlerësimit Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidates Elsa Toska, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 4.03.2019, duke e renditur të tretën në listën përfundimtare të renditjes së gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim me **85.428 pikë**.

- *Procesi i zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për shqyrtimin e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese*

Bazuar në nenin 7/c të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës e Shqipërisë”, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 29.10.2019 zhvilloi sipas renditjes seancat dëgjimore me 3 kandidatët për anëtar të Gjykatës Kushtetuese znj. Arta Vorpsi, znj. Elsa Toska dhe znj. Fiona Papajorgji.

Në fjalën hyrëse të tij Kryetari i Komisionit, sqaroi anëtarët e Komisionit, lidhur me arsyet e zhvillimit të seancës dëgjimore në mënyrë të përbashkët për vakancën e datës 12.02.2018 dhe për vakancën e datës 04.03.2019.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, kandidatët paraqitën përpara anëtarëve të Komisionit, në mënyrë të përmbledhur kualifikimet, përvojën e tyre profesionale si dhe platformën dhe vizionin e tyre për mënyrën e përmbushjes së detyrave si anëtar potencial i Gjykatës Kushtetuese. Kandidatët njëkohësisht iu përgjigjën pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e Komisionit.

Relatorja theksoi se Komisioni për çështjet ligjore nuk vlerëson në thelb vendimmarrjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar është organi përgjegjës për kryerjen e verifikimit të kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Kjo konsideratë, bazohet në vetë frymën e reformës në sistemin e drejtësisë, e cila ka synuar depolitizimin e procesit të emërimeve në pozicionet e larta në drejtësi, duke ulur diskrecionin e organeve politike të emërtesës me qëllim garantimin e cilësisë së drejtësisë kushtetuese dhe forcimin e besimit të publikut mbi pavarësinë e gjyqtarëve kushtetues në rolin e tyre të garantit të Kushtetutës.

Në përfundim Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbështetje të pikës 5 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar pas shqyrtimit të “listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë) e shpallur, nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 4.03.2019, raportit të arsyetuar të renditjes së tyre, si dhe të gjithë praktikës dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të përcjella pranë Kuvendit të Shqipërisë në datë 14.10.2019, duke vlerësuar se:

- kandidatët për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, i janë nënshtruar një procesi të hollësishëm të verifikimit të kushteve ligjore, pasurisë, integritetit dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe morale të zhvilluar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi;
- praktika e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për sa i takon procesit të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim, është kryer në mënyrë të plotë dhe në përputhje me detyrimet e ngarkuara këtij organi kushtetues sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.

me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendosi:

Të miratojë raportin për vlerësimin e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e plotë e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 4.03.2019, i cili së bashku me emrat e kandidatëve , me renditjen sipas vendimit nr.134, datë 21.09.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 4.03.2019”*,

1) Arta Vorpsi

2) Fiona Papajorgji

3) Elsa Toska

dhe me praktikën dokumentare për procesin e zhvilluar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përcillen seancës plenare, për votim.

R E L A T O R E

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

KRYETAR

ULSI MANJA